Intervistoi: Naser Pajaziti

IBNA: Qeveria e re po shfaqet me ambicie të mëdha për reforma. Kemi planin 3-6-9 dhe deklarime të vazhdueshme dhe përkushtim në realizimin e tij. Ju si ambasador si e shihni gjithë këtë momentum?

Thimonier: Axhenda e reformave është një udhërrëfyes i shkëlqyeshëm. Faza e projektimit dhe prezantimit ishte vërtetë një sukses i madh. Ajo mundësoi vendosjen e Maqedonisë në skenën evropiane dhe ndërkombëtare si një aktor pozitiv. Ajo shënoi fundin e një faze të stagnimit, apo edhe të regresit, në të cilën ju keni humbur një pjesë të përparimit tuaj fillestar në rrugën e integrimit për në BE dhe NATO. Kapitali i simpatisë është gjetur sërish, dhe tani duhet të transformohet në një kapital të ri të besimit, përmes reformave, por mbi të gjitha duhet gjetur një mënyrë e re e të bërit politikë dhe udhëheqjes së vendit. Kjo çështje vlen për të gjithë shoqërinë, e jo vetëm për partitë dhe autoritetet. Çështja e vërtetë nuk është një listë e thjeshtë e reformave, por se ky ndërrim dhe ndryshim korrespondon me një fillim të ri për shoqërinë e Maqedonisë. Vrulli u ndje. Tani ai duhet që të shfaqet dhe të materializohet apo konkretizohet duke përfshirë të gjitha vullnetet e mira. Jemi në momente vendimtare dhe të rëndësishme. I vëzhgojmë të gjitha sinjalet për të konfirmuar nëse axhenda është një program i vërtetë i ndryshimit. Andaj do të jemi në anën tuaj për ta përmbushur atë: kjo është një detyrë e solidaritetit evropian.

Problemi kyç është kontesti i emrit. Ka sinjale optimiste dhe një frymë e re. A vlerësoni se do të ketë zgjidhje të shpejt apo do ndodhë një reprizë e përpjekjeve të kaluara ?

Thimonier: Periudhën që po e lëmë pas ka qenë një periudhë krize për të dyja vendet në fjalë, të cilat tani po përjetojnë kohëra më të mira. Ky stabilitet duhet të përdoret për t'i dhënë fund paradoksit të të dy fqinjëve, të cilët ndajnë interesa të shumta të përbashkëta dhe orientimin e njëjtë strategjik, por që janë bllokuar nga një çështje, e cila ka kristalizuar dhe shtresuar paragjykimet, klishetë dhe reflekset, e që duhen të shihen me durim. Po shfaqet një frymë krejtësisht e ndryshme dhe e re, falë vullnetit të mirë të ministrave të Jashtëm të dy vendeve. Kjo do të ndihmojë në jetësimin në muajin dhjetor të procesit ndërkombëtar nën patronazhin e Kombeve të Bashkuara. Andaj vlerësoj se duhet të mbështetet kjo rrugë si dhe të gjitha nismat bilaterale ose rajonale të pajtimit. Zyrtarët grekë gjithashtu do të jenë më të rehatshëm në mbrojtjen e një marrëveshjeje të arsyeshme me një vend që është i qëndrueshëm brenda dhe i cili do të jetë në marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët e tjerë, si dhe i angazhuar në bashkëpunimin me institucionet e Brukselit. Çelësi thelbësor është kalimi nga një fazë kuazi-bllokuese në një dinamikë të re të bazuar në besimin real midis aktorëve, fazë kjo që pas hapave të vegjël do të mundësojë hapin e madh.

Ka një nismë për takimin e Parisit për intensifikimin e dialogut politik midis partive më të mëdha. VMRO-DPMNE nuk tha se nuk shkon dhe kjo po vë në pikëpyetje këtë nismë. Sa jeni të involvuar lidhur me këtë takim të planifikuar në kryeqendrën e juaj ?

Thimonier: Një jetë normale politike dhe parlamentare, përmbushja e kritereve demokratike dhe një shtet i dekolonizuar nga partitë, janë kushtet thelbësore për integrimin evropian të Maqedonisë. Ky rregull vlen për të gjitha shtetet në rajon, andaj forcat politike maqedonase duhet ta integrojnë plotësisht atë në veprimin e tyre, nëse duan t'i shërbejnë interesave të

popullit të tyre. Është e qartë se edhe më tej mbetet shumë për t'u bërë në drejtim të arritjes së këtij rezultati. Nuk e di nëse duhet shkuar në Paris për të zhvilluar një dialog të tillë, sepse është e qartë se disa nga pengesat që hasen këtu për arritjen e një demokracie funksionale, janë çështje individësh dhe asgjë më shumë, pa mos llogaritur interesat e lidhura më shumë me kleptokracinë, sesa me demokracinë. Ne po ndjekim nga afër përpjekjet e Kryetarit të Parlamentit dhe personaliteteve të guximshme për të gjetur mënyra praktike për ta bërë këtë. Vlerësojmë se duhet të zhvillohet një dialog i besueshëm me opozitën, e për të cilën nuk duhet të harrojmë asnjëherë se përfaqëson qytetarët, përmes deputetëve të saj.

Reformat në drejtësi janë kyçe. A mendoni se ky proces po ecën në rrugën e duhur pas emërimeve të prokurorit të ri të përgjithshëm dhe lëvizjet e tjera duke përfshirë edhe pakon e ligjeve që duhet të kalojë në Kuvend?

Thimonier: Reforma e drejtësisë është njëra prej reformave më të pritura dhe më të vëzhguara, sepse është kriteri parësor i sinqeritetit të autoriteteve, por njëkohësisht edhe i angazhimit të shoqërisë civile në ndërtimin e një shteti të vërtetë ligjor (shtet i së drejtës) dhe jo një instrument i hakmarrjes apo fuqisë. Prandaj normalisht se dialogu për këto tema është aktiv dhe interaktiv me evropianët që kanë përjetuar poashtu vështirësi të mëdha, e që hasen edhe sot në këtë fushë nga shtetet anëtare. Këtu, Franca ka qenë veçanërisht e përfshirë në trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve përmes bashkëpunimit dhjetëvjeçar me Akademinë dhe synon të vazhdojë investimet e saja për një sistem barazie dhe sistem transparent të punësimit të gjyqtarëve, duke premtuar paanshmërinë e tyre, pa harruar të pasqyrojë diversitetin e shoqërisë në përbërësit e saj. Nga ana tjetër, është e nevojshme që shumë juristë, që me guxim dhe përkushtim kanë kërkuar ndryshime në sjelljen e autoriteteve në lidhje me procedurat e emërimit apo avancimit, të mbajnë edhe më tej të njëjtin qëndrim dhe shqetësim etik. Në fund të fundit ndryshimi në drejtësi duhet të bazohet në integritetin dhe syçelësinë e qytetarëve, e jo në këshillat apo paralajmërimet e Brukselit. Andaj duhet të dëgjohen zërat e tyre, sepse do të jenë kriter thelbësor në rrugëtimin tuaj evropian.

Kemi edhe reformën në media, ku ligji i propozuar është shtruar për debat. Si i shihni zgjidhjet e propozuara ligjore dhe se a mund të bëhet diçka më shumë duke dëgjuar kërkesat e shoqatave të gazetarëve?

Thimonier: Mbizotëron një klimë e re në media pas një periudhe tensioni, agresioni apo kërcënimi ndaj gazetarëve, e cila ka ndikuar shumë në krijimin e përshtypjes në nivel ndërkombëtar, për mbretërimin e një krizë të thellë dhe strukturore në Maqedoni. Nevojitet kthim në një sistem më normal dhe pluralist dhe të çliruar sa më shumë që të jetë e mundur, nga ndërhyrjet partiake ose presionet ekonomike. Është një çështje thelbësore për të gjithë rajonin, andaj unë jam i gëzuar me faktin që ajo matet dhe vlerësohet në të gjithë rëndësinë e saj nga bashkatdhetari im Arlem Dezir, Komisioner i Lartë i OSBE-së për lirinë e medias. Gjatë vizitës së tij të fundit, ai përshëndeti përparimin e qasjes së kohëve të fundit, të ndërmarrë nga strukturat e reja politike, por duke theksuar arritjen e realizimit të tyre edhe në vepër. Ai këmbënguli në çështjen e krijimit të një shërbimi publik audiovizual, politikisht neutral dhe të pavarur. Kjo do të jetë me të vërtetë një çështje e rëndësishme me të cilën ne do të mund të gjykojmë dhe vlerësojmë realitetin e ndryshimeve të shpallura nga autoritetet e reja. Me këtë rast, i bashkangjitem urimeve të sinqerta të shprehura nga zoti Dezir për suksesin e « Gazetës së pavarur », e cila i përgjigjet më së miri emrit të saj. Një medium i shkruar me cilësi mbetet

njëri nga kushtet thelbësore të demokracisë.

A pajtoheni me deklaratën e Hahn se ligji për gjuhët nuk është prioritet dhe se para tij është pakoja e reformave. A duhet që ky ligji të marrë dritë jeshile sa më shpejt ?

Thimonier: Kërkesat e bëra nga BE janë të shumta dhe ngulmuese apo insistuese. Është shumë e rëndësishme që axhendat të respektohen, e kjo nuk do të jetë e lehtë në kushtet aktuale të punës së Parlamentit. Është e rëndësishme ta mbani këtë pikë në mendje dhe t`i adresoni çështjet me radhë dhe me kujdes gjatë kësaj legjislature. Vallë, a nuk do të ishte më mirë që të zhvillohej një debat i tillë për gjuhët, i cili megjithë ngarkesën e tij politike dhe emocionale, është fatkeqësisht i favorshëm për manipulime të padëshirueshme, atëherë kur do të zgjidhen pikat e tjera të axhendës, që janë fryt i konsensusit dhe kushtëzojnë afrimin drejt Evropës? Ja pra, pyetja mund të parashtrohet edhe kësisoj.

Kryeministri Zaev është shprehur optimist se deri në shkurtin e vitit të ardhshëm vendi do të arrijë të kryejë detyrat për të marrë vlerësimin dhe vendin që i takon në BE. Ju a jeni optimist sikur ai, në këtë drejtim ?

Thimonier: Optimizmi i Kryeministrit është një aset i vlefshëm. Nga takimet me të dalim me përshtypjen se ndryshimi udhëhiqet nga një vullnet i sinqertë. Shumë ministra ndajnë përshtypjen e njëjtë. Ata të gjithë duhet të përballen me peshën e një shoqërie të veçantë dhe të mbrojnë ndonjëherë interesa kontradiktore në një rrugë komplekse dhe kërkuese (ngulmuese) evropiane. Mirëpo, një pjesë e kohës së humbur viteve të fundit është arritur për disa muaj. Prandaj duhet të vazhdojmë me durim dhe vendosmëri. Mu ashtu siç ka deklaruar edhe presidenti Makron, se ndërtimi i Evropës nuk do të përfundojë deri në përfshirjen përfundimtare të Ballkanit Perëndimor. Ky është një udhërrëfyes i mirë për optimistët, ku bëjmë pjesë edhe ne. Nga tani e tutje, Maqedonia duhet të jetë një lajm i mirë kur flitet për integrimin evropian. /IBNA